Tax Alert Albania

Ndryshimet në ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare

Amendments to the law on accounting and financial statements

Shtator 2026

September 2026

Ligj nr. 87/2026, datë 23.7.2026, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar"
Përmbledhje e ndryshimeve kryesore

Ligji nr. 87/2026 sjell ndryshimin më të thellë të kuadrit kontabël që nga miratimi i ligjit nr. 25/2018. Fokusi kalon nga raportimi thjesht financiar te transparenca e zgjeruar – për qëndrueshmërinë, për strukturën e grupit dhe për tatimin e paguar. Shumica e detyrimeve të reja zbatohen nga periudha raportuese 2028.

Zhvillimet kryesore:

- **Raportimi i qëndrueshmërisë**
  Raportimi jofinanciar zëvendësohet nga raportimi i qëndrueshmërisë. Shoqëritë me mbi 1.000 punonjës dhe mbi 45 miliardë lekë të ardhura do të raportojnë për klimën, çështjet sociale dhe drejtimin, duke përfshirë objektivat për uljen e gazrave që ndikojnë në efektin serë për vitet 2030 dhe 2050. Raportimi shtrihet edhe te zinxhiri i vlerës, pra te furnitorët dhe partnerët, ndërsa shoqëritë e vogla brenda këtij zinxhiri mbrohen nga kërkesat e zgjeruara. **(nenet 18/1 dhe 18/2)**

- **Raportimi në nivel grupi dhe auditimi**
  Grupet që tejkalojnë të njëjtin prag përgatisin një raport të vetëm qëndrueshmërie për të gjithë grupin, sipas standardeve të miratuara nga Komisioni Evropian. Risia me kosto më të drejtpërdrejtë është auditimi: raporti i nënshtrohet detyrimisht një angazhimi për dhënie sigurie nga një auditues ligjor. Detyrimi prek edhe filialet dhe degët shqiptare të grupeve të huaja me mbi 20 miliardë lekë të ardhura. **(nenet 20/1–20/7)**

- **Transparenca tatimore publike**
  Grupet dhe shoqëritë me mbi 75 miliardë lekë të ardhura do të publikojnë informacionin tatimor shtet-më-shtet, i cili deri tani i raportohej vetëm administratës tatimore si informacion konfidencial. Publikohen aktiviteti, punonjësit, të ardhurat, fitimi para tatimit, si dhe tatimi i llogaritur dhe ai i paguar realisht, brenda 12 muajve nga data e raportimit. **(nenet 23/1–23/4)**

- **Konsolidimi, shënimet dhe publikimi**
  Detyrimi për pasqyra financiare të konsoliduara lidhet tashmë me kontrollin real mbi njësinë – shumica e votave, e drejta e emërimit të drejtuesve, ndikimi dominues – dhe jo thjesht me përqindjen e pronësisë. Zgjerohen shënimet shpjeguese, ulet pragu i raportimit të pagesave ndaj institucioneve shtetërore dhe pasqyrat publikohen edhe në faqen zyrtare të internetit. Gjithashtu, personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare duhet të përgatisë një deklaratë pajtueshmërie, e cila publikohet së bashku me pasqyrat financiare vjetore. Forma dhe përmbajtja e kësaj deklarate do të miratohen me urdhër të ministrit të Financave. **(nenet 12/1, 16, 21, 22 dhe 23)**

Burimi: Ligj nr. 87/2026, datë 23.7.2026 (Link)

©2026 PwC. Të gjitha të drejtat e rezervuara. PwC i referohet rrjetit PwC dhe/ose një ose më shumë firmave anëtare të tij, secila prej të cilave është një njësi juridike e veçantë. Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni www.pwc.com/structure. Ky material është ofruar vetëm për qëllime të përgjithshme informuese dhe nuk duhet të përdoret si zëvendësim për këshillimin me këshilltarë profesionalë.

Law no. 87/2026, dated 23.7.2026, "On some amendments and additions to Law no. 25/2018, "On accounting and financial statements", as amended"
Summary of the key amendments

Law no. 87/2026 brings the most significant change to the accounting framework since Law no. 25/2018 was adopted. The focus shifts from purely financial reporting to broader transparency – on sustainability, on group structure and on tax paid. Most of the new obligations apply from the 2028 reporting period.

Key developments:

- **Sustainability reporting**
  Non-financial reporting is replaced by sustainability reporting. Companies with more than 1,000 employees and turnover above ALL 45 billion will report on climate, social matters and governance, including greenhouse gas reduction targets for 2030 and 2050. Reporting also extends to the value chain, meaning suppliers and partners, while smaller companies within that chain are protected from excessive requests. **(Articles 18/1 and 18/2)**

- **Group-level reporting and assurance**
  Groups exceeding the same threshold prepare a single sustainability report for the entire group, in accordance with the standards adopted by the European Commission. The change with the most direct cost is assurance: the report is subject to a mandatory assurance engagement performed by a statutory auditor. The obligation also affects Albanian subsidiaries and branches of foreign groups with income above ALL 20 billion. **(Articles 20/1–20/7)**

- **Public tax transparency**
  Groups and companies with income above ALL 75 billion will publish country-by-country tax information, which until now was reported only to the tax administration as confidential information. Disclosures cover the activity, employees, income, profit before tax, as well as the tax accrued and the tax actually paid, within 12 months of the reporting date. **(Articles 23/1–23/4)**

- **Consolidation, disclosures and publication**
  The obligation to prepare consolidated financial statements is now linked to actual control over the entity – a majority of votes, the right to appoint management, dominant influence – rather than merely to the ownership percentage. The notes are extended, the threshold for reporting payments to government bodies is reduced, and the financial statements must also be published on the official website. In addition, the person responsible for preparing the financial statements must issue a compliance statement, which is published together with the annual financial statements. The form and content of this statement will be approved by order of the Minister of Finance. **(Articles 12/1, 16, 21, 22 and 23)**

Source: Law no. 87/2026, dated 23.7.2026 (Link)

©2026 PwC. All rights reserved. PwC refers to the PwC network and/or one or more of its member firms, each of which is a separate legal entity. Please see www.pwc.com/structure for details. This content is for general information purposes only, and should not be used as a substitute for consultation with professional advisers.



Contact us

PwC Albania

Address: Str. “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, 9/1 Tirana, Albania
Telephone: +(355) 42 242 254
Email: al_pwc_albania@pwc.com
Web: www.pwc.com/al